



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.11

Prishtinë, më 15.09. 2020, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Në mbledhje morën pjesë: Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit, Bekë Berisha, nënkryetar i parë, Rexhep Selimi, Mefail Bajqinovci, Ilir Tasholli, Hatim Baxhaku, Elmi Reçica, Ganimete Musliu, Rasim Demiri, anëtarë.

Mungoi: Haxhi Shala, Slavko Simiq.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.06.2020;
3. Kërkesa e Agjencisë për Informim dhe Privatësi për autorizim;
4. Njoftim nga Sindikata e Policisë së Kosovës;
5. Të ndryshme

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetarja, fillimisht kërkoi që me rastin e vdekjes së aktorit, deputetit z.Adem Mikullovc, të mbahet një minutë heshtje për të shprehur nderimin për këtë njeri të madh. Lavdi jetës dhe veprës së z.Mikullovc.

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit i mbledhjes së mbajtur me 24.06.2020.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Kërkesa e Agjencisë për Informim dhe Privatësi për autorizim.

Kryetarja, njoftoi që në adresë të Komisionit ka ardhur kërkesa e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për tu dhënë autorizimi, duke qenë se dështoi procesi për zgjedhjen e Komisionerit të Agjencisë edhe pse procesi shkoi në rregull, por nuk u arritën votat e mjaftueshme. Sa i përket çështjes së shtruar, theksoi se Komisioni nuk ka kompetenca të jap një autorizim të tillë, por duhet të vazhdojmë tutje me shpalljen e konkursit.

Rexhep Selimi, lidhur me mos zgjedhjen e Komisionerit, e konsideroi si dështim, duke qenë se kanë humbur fondet si dhe mbështetjen e Ambasadës Britaneze. Tutje theksoi se zgjidhjen e kësaj problematike mund të inicioj Komisioni, pasi në Ligj është përcaktua shumica e caktuar, nëse përsëritet mund të dështoj prape, andaj propozoi plotësim/ndryshimin e Ligjit, në mënyrë që të përcaktohet cilësia e votës në mënyrë që të zgjidhet Komisioneri.

Kryetarja, lidhur me mangësitë e ligjit për mbrojtjen e të dhënave, theksoi se nuk është e përcaktuar as raundi i dytë, pastaj mangësitë në institucionin e konkursit, kanë qenë pengesë.

Elmi Reçica, sa i përket çështjes së Komisionerit, theksoi se Komisioni ka bërë shuam mirë punën e vet, por procesi dështoi në seancë plenare. Tutje theksoi se është dakord që të bëhet një standard për zgjedhjen e çështjeve të ngjashme, andaj mund të bëhet edhe ndryshimi i ligjit. Ndërsa sa i përket kërkesës së bërë nga ana z.Bujar Sadiku, theksoi se kjo nuk është në kompetencën e Komisionit por të Kryesisë së Kuvendit.

Rexhep Selimi, shtoi se ato çështjet që nuk parashihen në ligj, sa i përket zgjedhjes së bordeve apo kryesuesve të institucioneve të pavarura, mund të ofroj ndihmë, por për ato që përcaktohen në ligj, nuk e bën një gjë të tillë, pasi kjo çështje është diskutuar në mbledhjen e fundit të Kryesisë.

Ganimete Musliu, theksoi se Komisioni ka bërë punën e tij, ndërsa sa i përket kërkesës së bërë nga z.Sadiku, theksoi se duke u bazuar në disa precedent të mëhershme, kjo kërkesë mund të procedohet për Kryesi, ndërsa sa i përket ndryshimeve ligjore, Komisioni mund të marrë këtë

iniciativë, pasi me ligjin aktual, nuk do të mund të zgjidhet dh mund të dështoj sikurse në proceset e mëhershme.

Bekë Berisha, lidhur me përzgjedhjen e Komisionerit, theksoi se duhet të xhindet një formë në mënyrë që të funksionalizohet ky institucion.

Kryetarja, lidhur me kërkesën e z.Sadiku, theksoi se kjo kërkesë duhet të procedohet për Kryesinë e Kuvendit, pasi do të shqyrtohet edhe nga zyra ligjore. Ndërsa sa i përket shpalljes së konkursit, Komisioni në vazhdimësi do të ndërmarr hapa.

4. Njoftim nga Sindikata e Policisë së Kosovës.

Kryetarja, fillimisht theksoi se nga ana e Sindikatës së Policisë së Kosovës, janë paraqitur disa kërkesa, për këtë qëllim kemi ftuar sot dy përfaqësues të sindikatës së policisë. Fjalën ua kaloi përfaqësuesve të sindikatës.

Shaban Tasholli, Nënkryetar i Sindikatës së Policisë së Kosovës, theksoi se kërkesat e tyre kanë qenë të ndryshme, fillimisht janë fokusuar tek sigurimi shëndetësor dhe tek pensioni i hershëm. Këto kërkesa nuk kanë kaluar, por kohët e fundit janë detyruar të ndërmarrin hapa, pasi policia punon nga dymbëdhjetë orë, nuk ka shujtë, nuk i paguhet ndërrimi i natës, ndërsa orët shtesë mbi 60 orë nuk paguhen. Kërkesa e policisë është që në pakon emergjente, të përfshihen edhe këto kërkesa, pasi deri në këtë moment nuk ka asnjë përgjigjeje nga Qeveria e Kosovës. Protesta do të ndodhë edhe pse nuk e dëshirojmë, në Qeverinë e kaluar janë dhënë ndihmë prej 300 euro, ndërsa në këtë Qeveri kjo shumë është ndaluar dhe nuk ka asnjë përgjigjeje. Gjithashtu krahasoi pensionet me ato të FSK-së, ku është një dallim i madh sikur të ishte një shtet tjetër, për këtë nuk ka as ku të ankohet dhe askush nuk ka marrë hapa.

Valbona Kamberi, Kryetare e Sindikatës së Policisë së Kosovës, fillimisht theksoi se kërkesat për policinë nuk janë të sotshme, janë edhe të viteve të mëhershme, pasi për pesëmbëdhjetë vite, policia është përballur me sfida të ndryshme, pakënaqësia është e madhe sidomos për kërkesat e fundit, ku tre prej tyre janë dërguar në Qeveri, Ministrit të Punëve të Brendshme, Drejtorit të Policisë. Policia e Kosovës që nga 12 marsi punon 12 orë, pa përjashtim të pushimit, nuk ka stimulim për policët dhe duhet të dihet se ku është qëllimi politik i udhëheqësve, duke qenë se policia është në vijën e fronti kundër pandemisë. Janë mbi gjashtëqind zyrtar policor të infektuar, ndërsa dhjetë pjesëtar kanë humbur jetën, ndërsa dhënia e stimulimit për punonjësit e shëndetësisë, ka krijuar pakënaqësi në policinë e Kosovës, ku përpos pakos emergjente, ka pakënaqësi edhe për kompensimin për ndërrimin e natës, nuk paguhet konform ligjit të punës, pasi paguhet vetëm pesë euro. Në ligjin e policisë parashihen të gjitha shtesat, përfshirë shtesën e rrezikshmërisë, sigurimit shëndetësor, shtesa për shujtë ditore, pagesa e fundjavës, festave dhe ndërrimit të natës. Sa i përket orëve shtesë, ka vërejtje pasi në sistemin e pagesave nuk janë paguar disa pjesëtar për orët shtesë që kanë bërë, pasi sipas udhëzimit administrativ në fuqi, paguhen deri në dyzet orë, ndërsa gjatë kohës së pandemisë janë paguar deri në gjashtëdhjetë orë, por duke qenë se ka shumë angazhim, mund të punojnë deri në treqind orë, ku mbi gjashtëdhjetë orë i kompensohen me ditë pushimi, ndërsa mos marrja e pushimit gjatë kohës së pandemisë, ka shkaktuar pakënaqësi, kjo ka bërë që zyrtarët policor të kenë lodhje psikike dhe fizike. Për muajin gusht akoma nuk janë identifikuar se sa zyrtar nuk janë paguar, por ka

informacione që nuk ka buxhet. Si është e mundur që nuk ka buxhet për të paguar zyrtarët policor? Ndërsa theksoi se deklaratat e disa politikanëve që kanë thënë që zyrtarët policor nuk po e kryejnë punë e tyre, ka shkaktuar indinjim tek sindikata, pasi janë zyrtarët policor që janë të obliguar në zbatimin e masave kundër pandemisë. Tutje theksoi se janë paralajmëruar protestat, ndërsa forma e protestës do të vendoset nga këshilli drejtues i Sindikatës dhe mjetet sindikale do të përdoren, siç është pasiviteti. Zyrtarët policor nuk kanë as maska, duhet ta blejnë vet, punojnë pa shujtë vetëm në zbatimin e ligjit.

Bekë Berisha, theksoi se i kupton shqetësimet e policëve, pasi për një kohë askush nuk është marrë me kërkesat e tyre, po konsideroi se ka ardhur koha që të mbështeten kërkesat e policisë, duke shtuar që është partner për kërkesat e policisë.

Mefail Bajqinovci, sa i përket pakos ushqimore në polici, me sa ka informacion në Policinë e Kosovës është tenderi që ka të bëjë me furnizimin me ushqim. A është për të gjithë policët apo vetëm për një pjesë? Sa është numri i pjesëtarëve të policisë që kanë arritur moshën gjashtëdhjetë vjeçare? Sa i përket orët shtesë, duke qenë se deri në gjashtëdhjetë orë janë paguar, a ju lejohet pushimi?

Ilir Tasholli, lidhur me kontributin e policisë, theksoi se ka qenë i ngjashëm me atë të shërbimit shëndetësor, duke qenë preventivë për pandeminë. Ndërsa sa i përket paralajmërimit për protestë, theksoi se do duhet të shikohen mundësitë në mënyrë që mos të arrihet deri në atë nivel, por të gjinden zgjidhjet për policinë.

Rexhep Selimi, theksoi se ndihet i shqetësuar me atë çfarë ka dëgjuar në këtë takim, për gjendjen e policisë së Kosovës, pasi në çdo situatë, policia ka qenë aleat dhe Komisioni jep mbështetjen e plotë për plotësimin e nevojave të policisë. Propozoi që Komisioni të formoj një grup punues për mbikëqyrje e Ligjit të Policisë si dhe situatës aktuale të krijuar, ndërsa mos përgjigjeje nga ana e Qeverisë, Kryeministri e konsideron shqetësuese, duke qenë se aleatët kryesor në këtë situatë janë policët.

Ganimete Musliu, fillimisht falënderoi pjesëtarët e policisë për punën që po bëjnë dhe angazhimin e tyre sidomos në kohën e pandemisë, pasi përballja e institucioneve të Kosovës me pandeminë nuk ka qenë e lehtë, ndërsa theksoi se edhe gjatë muajit korrik janë ngritur këto shqetësime por nuk janë marrë seriozisht, ndërsa kërkoi që Komisioni të del unanim në mbështetjen e kërkesave të policisë. Gjithashtu kërkoi që nga ana e policisë të ketë profesionalizëm, pasi janë disa raste kur kemi parë disa skena lidhur me skenat e bëra nga ana e policisë, duke shtuar që edhe personalisht ka përvojë të tillë, por nuk duhet përfshirë të gjithë pasi policia bënë punë të jashtëzakonshme.

Elmi Reçica, fillimisht theksoi se Policia e Kosovës ka nevojë për mbështetje, duke qenë se Komisioni ka për detyrë aspektin e mbikëqyrjes së ligjeve dhe duhet të bëjë punën e vet, gjithashtu thekso se edhe zjarrëfikësit janë kategoria që duhet të mbështeten. Komisioni duhet të fokusohet në kërkesat e menjëhershme, duke shtuar që nuk duhet të ketë dallime mes policisë dhe Forcave të Armatosura, sa i përket aspektit të rregullimit të pagave dhe pensione, duke shtuar që në polici nuk duhet të shprehur nervozizmi për shkak të punës së rëndë, por sipas

mundësisë duhet të jetë brenda asaj çfarë është ligjore, duke kërkuar që të bëhet zgjidhje që mos të vije deri te protestat apo bojkotimi i punës, duke shpresuar që Qeveria të bëjë zgjidhje sa më shpejtë.

Hatim Baxhaku, lidhur me kërkesat e policisë, theksoi se në këtë fazë është e rëndësishme që ti jepen rëndësi disa pikave, pagesave e orëve shtesë, ndërrimi i natës, shujta si dhe pagesa prej treqind eurove nga pakoja emergjente, më pastaj të bëhet zgjidhje edhe për kërkesat e tjera.

Rasim Demiri, theksoi se kërkesat e policisë janë dëgjuar me shumë kujdes dhe falënderoi për kontributin e dhënë deri tani. Ndërsa sa i përket paralajmërimit për protesta theksoi se është kundra tyre, pasi duhet parë zgjidhja fillimisht duke qenë se jemi në kohë pandemie. Gjithashtu shtoi se është në njohuri për mungesat që kanë zyrtarët policor, ndërsa theksoi që nuk qëndrojnë mirë edhe pjesëtarët e FSK-s duke qenë se u krahasua edhe me ta, por kërkoi që të gjinden zgjidhje për mungesat si në polici ashtu edhe në FSK.

Valbona Kamberi, Kryetare e Sindikatës së Policisë së Kosovës, lidhur me ushqimi për pjesëtarët e policisë, theksoi se nuk është i njëjtë për të gjithë, pasi është një marrëveshje për ti ofruar shërbimet e ushqimit për njësitë elite(Njësitë e mbrojtjes së afërt, njësit e specializuara dhe njësit e reagimit të shpejt) ndërsa me këtë marrëveshje ushqehet edhe flota operative, ndërsa 9800 pjesëtar të tjerë nuk e kanë shujtën ditore. Ndërsa sa i përket moshës mesatare theksoi se është 50 vjet, duke shtuar se në këtë moshë nuk kanë kondicionin dhe mundësinë për të reaguar, ndërsa edhe për pensione kërkoi që të jenë më të mëdha, duke qenë se numri i zyrtarëve policor që i mbijetojnë pensionit nuk është as 4.5 për qind, prandaj nuk është buxhet i kushtueshëm, ndërsa nuk ka gatishmëri nga Qeveria për të proceduar këtë projektligj, ndërsa sa i përket orëve shtesë theksoi se një pjesë e tyre nuk janë paguar dhe kjo nuk është e kuptueshme si nuk mundën të paguhesh orët, ndërkohë zyrtarët policor nuk arrin të marrin as pushimin, duke qenë se janë të ngarkuar nga muaji mars me orë shtesë. E vetmja Policia e Kosovës është në rajon që nuk ka sigurim shëndetësor, nuk paguhet puna e vikendeve, gjatë festave andaj kërkoi që të merren parasysh këto kërkesa.

Bekë Berisha, shtroi pyetjet për përfaqësuesit e sindikatës. A ka çështje, të cilat janë ngritur këtu, që mund të zgjidhen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë? Pse nuk kthehet gjendja në normalitet, me tetë orë punë? Pse nuk ndërmerren veprime për të rregulluar situatën?

Shaban Tasholli, theksoi se sa i përket problemeve të brendshme, mund të zgjidhen lehtë, pasi vetëm orët shtesë që duhet të paguhesh kushtojnë pesë milion euro, stafi menaxher e ka vullnetin që të paguaj, por nuk ka buxhet, ndërsa Qeveria ka marrë pesë milionë gjysmë nga buxheti që ishte ndarë për policinë, gjatë rishikimit të buxhetit, ndërsa sa i përket ndërrimit të natës do të merret vendimi nga drejtori, sikurse shëndetësia, pasi është mundësia ligjore. Ndërsa sa i përket asaj që disa sjellje të zyrtarëve policor, theksoi se nuk është pasqyrë e mirë që të shihen zyrtarët policor të shtrirë për toke, ndërsa theksoi se mirësjellja e dy anshme është e rëndësishme, si nga qytetarët ashtu edhe nga policët, por mbi policinë është mbikëqyrja dhe merren masa për çdo rast që mund të ketë shkelje.

Kryetarja, falënderoi përfaqësuesit e sindikatës për njoftimin e bërë, Komisioni i konsideron kërkesat e arsyeshme dhe do të kërkoj për përmbushjen e kërkesave që janë të nevojshme në këtë kohë dhe se përkrahja e Komisionit nuk do të mungoj

4. Të ndryshme

Nuk pati çështje për tu diskutuar.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:46

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetare e komisionit,

Fatmire Kollçaku